



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 41/2015

Prishtinë, më 08.12.2015, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK,
INFRASTRUKTURË, TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Muhamet Mustafa - kryetar, Sasha Milosavljeviq, Besim Beqaj, Raif Qela, Sala Berisha-Shala, Fatmir Rexhepi, Blerim Grainca dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Visar Ymeri, Pal Lekaj dhe Enver Hoti, anëtarë.

Pjesëmarrës të tjerë: Dukagjin Shala dhe Skender Sallahu-MZHE; Dardan Abazi dhe Visar Berisha-INDEP; Fjolla Uka - KDI; Lejla Selimi- OSBE; Mejreme Tahirukaj- Radio Kosova; Arta Rexha –Rrokum. Tv dhe Besa Maliqi- Birn/ Kallxo.com.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi: Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.12.2015;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-058 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;
4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;
5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE;
6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP;
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Miratimi i rendit të ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 4.12.2015

Procesverbali i mbledhjes së datës 4.12.2015, u miratua me vërejtjet e deputetit Raif Qela, i cili do t'ia dërgojë stafit më shkrim.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-058 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare

Kryetari Muhamet Mustafa i njoftoi anëtarët e Komisionit, lidhur me Projektligjin nr. 05/L-058 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare, se ky projektligj është nismë e komisionit që është dërguar në Qeveri për të marrë opinionin sipas procedurës, por afati kohor ka përfunduar dhe nuk është kthyer ndonjë opinion. Konsiderohet së është pranuar në heshtje. Pastaj fjalën ia dha znj. Sala Berisha-Shala, nismëtare dhe kryesuese e grupit të punës për të paraqitur arsyetimin e Projektligjit në fjalë.

Sala Berisha - Shala, në cilësinë e nismëtares dhe kryesuses së grupit të punës paraqiti arsyeshmërinë e nismës legislative. Pasi që Projektligji është nismë e Komisionit, tha ajo, në bazë të procedurave e kemi dërguar në Qeveri. Qeveria deri më tani nuk ka dhënë ndonjë përgjigje se Projektligji në fjalë nuk është në harmoni me legjislacionin vendor. Prandaj edhe afati njëmuor ka kaluar, në këtë mënyrë heshtja është pranim dhe se Projektligji për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare i plotëson të gjitha kushtet për miratim në parim në Kuvend. Tha se është një rregullore që e rregullon këtë fushë, por e kemi parë të arsyeshëm së më anë të Ligjit, mund të mbrohet më mirë siguria në punë në miniera. Me miratimin e këtij ligji fuqizohet edhe më shumë legjislacioni në fushën minerare.

Kryetari tha se pasi që për këtë projektligji kemi diskutuar gjerë e gjatë, propozoi që të miratohet dhe mbetet ai grupi i punës që e ka hartuar Projektligjin edhe tash, në këtë fazë.

Komision njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. Miratohet në parim projektligji nr. 05/L-058 për Siguri në Punë në Veprimtarinë Minerare;

2. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputetja Sala Berisha- Shala.

3. Grupi i punës për shqyrtimin e këtij Projektligji, pas miratimit të parim nga Kuvendi, do të jetë në këtë përbërje: Sala Berisha- Shala kryesuese, Raif Qela dhe Enver Hoti, anëtarë.

4. Shqyrtimi i Raportit me Rekomandime i Projektligjit nr. 05/L-052 për Energjinë Termike

Kryetari i njoftoi se komisionet e përhershme e kanë shqyrtuar Projektligjin Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike dhe amendamentet e propozuara nga komisioni ynë dhe nuk kanë dhënë ndonjë vërejtje apo propozim.

Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

1. Miratohet Raporti me Rekomandime i Projektligjit Nr. 05/L-052 për Energjinë Termike;

2. Raporti me Rekomandime t'i procedohet Kuvendit për lexim të dytë.

5. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE

Kryetari lidhur me këtë pikë tha e kemi diskutuar edhe në mbledhjen e kaluar ku ka mbetur që të kompletohen dokumentet shtesë për kandidatet e propozuar për Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE-së. Dokumente shtesë kemi pranuar nga Qeveria, përveç që nuk kemi marrë asnjë material nga kandidati Qemajl Mustafa dhe, tani duhet ta procedojmë tutje propozim-vendimin e Qeverisë si vijon: Arsim Janova, Qemajl Mustafa dhe Besim Sejfiqaj, këta shkojnë në pako në Kuvend. Dhe, duhet ta miratoj Kuvendi sepse Bordi i ZRRE-së ka vetëm 2 (dy) anëtarë, pra është jofunksional, ndërsa të kërkohet edhe nga Qemajl Mustafa, që para votimit në seancë të kompletojë dokumentacionin në bazë të Ligjit për Rregullatorin Energjisë.

Raif Qela propozoi që kjo pikë rendit të ditës të shtyhet për 2-3 muaj, dhe të fillojë nisma për plotësim ndryshimin e Ligjit për Rregullatorin Energjisë, pasi që ky ligj e parasheh votimin në bllok. Votimi në bllok nuk na jap zgjedhjen e duhur për t'i zgjedhur kandidatet më të mirë dhe të përgatitur profesionalisht. Prandaj, nëse behët ndryshimi i Ligjit për Rregullatorin Energjisë ne i ndryshojmë këto nene dhe e lejojmë që mënyra e votimit të jetë veç e veç, atëherë do ta kemi më lehtë marrjen vendimit për votim, sepse do të kemi mundësi t'i votojmë dhe zgjedhim kandidatet më të mirë, qoftë të përgatitur profesionalisht dhe moralisht. Sepse në këtë formë si është tani s'kemi nevojë fare ne, si komision, t'i shqyrtojmë këto lista me kandidat vetëm sa për t'ua bërë aminin.

Besim Beqaj tha se të drejtën për propozimin e Bordeve e ka Qeveria dhe përgjegjësia për kualitet dhe cilësi është e tyre, nëse nuk tregojnë performancë të mirë në punët e tyre. Ne, si komision, tani vetëm mund të aprovojmë dhe të rekomandojmë "Për" ose "Kundër" për t'i proceduar për votim në seance plenare, ndërsa Kuvendi vendos a me zgjedhur këtë Bord apo me ia kthyer Qeverisë. Ne nuk kemi mundësi të tjera në bazë të Ligjit dhe Rregullores së Kuvendit.

Fatmir Rexhepi tha Propozim-Vendimi i Qeverisë për Bordin e ZRRE-së, në aspektin e procedurave janë në rregull, por Qeveria më propozimin e kandidateve ka bërë shkelje ligjore, pasi që nuk ka respektuar kriteret, meqë të 3 (tre) kandidatet janë anëtarë aktiv të partive politike. Në aspektin profesional p.sh. Qemajl Mustafa, i plotëson të gjitha kushtet, por në sqarim duhet të jemi korrekt. Ne parim jam “Për” miratimin e këtij propozimi për t’i dërguar për votim në seancë plenare.

Raif Qela u shpreh se baza e saktë ligjore thuhet se duhet të votohet në pako, por ne po bëhemi bashkëpjesëmarrës të propozimet të Qeverisë. Prandaj, atë që po insistojë është që të ndryshohet ligji që të na jepet mundësia të bëhet votimi veç e veç për çdo kandidat, sepse më votimin në bllok mund të kalojnë edhe kandidat, të cilët nuk kanë përgatitje profesionale, që kanë të bëjnë me Rregullator të Energjisë dhe vendimet e tyre mund ta dëmtojnë reputacionin, qoftë të këtij rregullatori, qoftë edhe interesat e vendit.

Sala Berisha-Shala tha që edhe me parë kam thënë nuk mund ta lidhim perfektin më të mirën sepse këtë s’mund ta arrijmë. Prandaj miratimi i Bordit të ZRRE-së, është domosdoshmëri, pasi që ky bord nuk është i kompletuar dhe nuk është funksional për të marrë vendime. Ne si Kuvend nuk duhet me lënë, me pasur kaq shumë zbrazëti nëpër Borde, sepse në shumicën agjencive vendimet merren nga Bordet dhe është emergjent t’i kemi funksionale Bordet. Pastaj do ta shikojmë bazën ligjore për t’i ndryshuar ligjet në ato nene ku rregullohet zgjedhja e tyre.

Blerim Grainca tha po e shoh se procedurat janë respektuar nga mbledhja e kaluara. Ne kemi kërkuar me u plotësuar dokumentacioni për kandidatet e propozuar. Pasi që dokumentacionet i kanë plotësuar, kërkoj të procedohen për seancë plenare për miratim. Prandaj, ne duhet ta shtojmë angazhimin tonë për mbikëqyrjen e këtyre bordeve nëpër agjenci, sepse kjo është mundësia e jonë ligjore që kemi në bazë të ligjeve në fuqi.

Kryetari lidhur më votimin që duhet të bëhet në pako, tha se mënyra e votimit është rregulluar më Ligj që është në fuqi, nuk na lejon votimin veç e veç. Lidhur me aspektin e angazhimit politik e kemi konsultuar edhe zyrën ligjore të Kuvendit, dhe interpretimi i tyre është: “Bazuar në Ligjin nr. 03/L-185 për Rregullatorin e Energjisë, neni 5, paragrafi 3, ndalesat e parapara për anëtar të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, janë gjatë ushtrimit të mandatit, jo para fillimit të ushtrimit të mandatit”. Pajtohem më z. Qela, të filloj nisma për ndryshimin e Ligjit, por tani kjo çështje është urgjente sepse kemi mungesë të Bordit të ZRRE-së, dhe shumë vendime për politikën e rregullatorit për energji duhet të merren nga Bordi. Ai tha ne do të njoftojmë Kuvendin që kemi kërkuar nga kandidatet e propozuara për anëtarë të Bordit të ZRRE-së, dokumente dhe zotimi i tyre është se në momentin që votohen në Kuvend dhe zgjedhën anëtarë të Bordit të ZRRE-së do të japin dorëheqje nga postet e partive dhe pozitat e tjera zyrtare.

Raif Qela tha se pajohet të votoj “Për” nëse rekomandohet që institucionet përgjegjëse të iniciojnë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve përkatëse në mënyrë që për Bordet e agjencive të pavarura, të votohet veç e veç për secilin kandidat, e jo në paket, siç është rasti tani në shumicën e këtyre Bordeve.

Sala Berisha-Shala, tha që është kundër rekomandimet që procedohet në Kuvend për institucionet përgjegjëse të iniciojnë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve përkatëse lidhur me votimin dhe zgjedhjen e tyre.

Pas debatit, Komisioni më shumicë votash nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të aprovojë propozimin e Qeverisë, për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si vijon:

- 1.1. Arsim Janova,*
- 1.2. Qemajl Mustafa,*
- 1.3. Besim Sjeftaj.*

2. Kandidati Qemajl Mustafa, të plotësojë dokumentacionin shtesë.

3. Të gjithë kandidatët pas zgjedhjes në Kuvend, duhet të japin dorëheqje nga anëtarësimi në partitë politike, në përputhje me nenin 5, paragrafi 3 i Ligjit nr. 03/L-185 të Zyrës së Rregullatorit.

4. Rekomandohet që institucionet përgjegjëse të iniciojnë ndryshimet dhe plotësimet e ligjeve përkatëse në mënyrë që për Bordet e Agjencive të Pavarura, të votohet veç e veç për secilin kandidat, e jo në paket, siç është rasti tani në shumicën e këtyre Bordeve.

5. Arsytimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

6. Shqyrtimi i Propozim-Vendimit të Qeverisë për Bordin e Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP

Kryetari lidhur me këtë pikë tha e kemi shtyrë nga mbledhja e kaluar pasi që nuk e kishin dokumentacion e kompletuar edhe këta kandidatë, ndërsa tani e kanë sjellë. Po ashtu edhe ky Propozim për kandidatet për anëtarë në Bordin e Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare – ARKEP e parasheh Ligji Nr. 04/L-109 për komunikimet elektronike, që votimi të bëhet në pako, duke u bazuar në Neni 78. Në bazë të CV-ve cekën se a kanë përgatitjen profesionale, përveç kandidati Nijazi Ademaj i cili nuk i plotëson kushtet, pasi që nuk ka fakultet adekuat, ka diplomuar në makineri, ndërsa ligji e kërkon të jetë nga fusha e elektroteknikës, ekonomisë apo drejtësisë.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

R e k o m a n d i m

1. Të emërohen 5 (pesë) të propozuarit e Qeverisë, për anëtarë të Bordit të Autoritetit Rregullator për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP, si vijon:

- 1.4. Kreshnik Gashi,*

- 1.5. Nijazi Ademaj,
- 1.6. Hazir Hjadari,
- 1.7. Bahri Anadolli,
- 1.8. Shqiprim Pula.

2. Kandidati Nijazi Ademaj, nuk e ka kualifikimin e kërkuar sipas nenit 78, paragrafi 5 të Ligjit nr. 04/L-109 për komunikime elektronike.

3. Arsyetimin e rekomandimit e paraqet, deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit.

7. Të ndryshme

Çështje vijuese

a) Amendamentet për Projektligjin për buxhetin e Kosovës për vitin 2016

Kryetari i njoftoi anëtarët e komisionit se Komisioni për Buxhet dhe Financa, i ka shqyrtuar amendamentet e propozuara nga Komisioni ynë dhe rekomandimet e Komisionit për buxhet janë këto:

- **Amendamenti 1**, nuk është përkrahur (është në tabelë Amendamenti 56);
- **Amendamenti 2**, është përkrahur në shumë dhe qëllimin e kërkuar, por është bërë amendament i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pasi që, pas këshillave të përfaqësuesve të Ministrisë së Financave, është vlerësuar se kemi të bëjmë me mjete për mallra dhe shërbime dhe jo për investime kapitale (është në tabelë Amendamenti 46, pika 1.1);
- **Amendamenti 3**, është përkrahur (është në tabelë Amendamenti 54).

Sala Berisha-Shala tha që ka arsye dhe argumente që është dashur të miratohet Amendamenti 1, por tha se këtë amendament do ta arsyetojë gjatë shqyrtimit të dytë të Projektligjit në seancë plenare dhe kërkoj nga deputetët e Komisionit që ta përkrahin.

b) Vizita në Shqipëri

Kryetari i njoftoi anëtarët e Komisionit se kjo vizitë ka qenë e paraparë të realizohet gjatë muajit nëntor, por është anuluar për shkak të seancës plenare. Tani është planifikuar të realizohet në bazë të agjendës prej datës 16-18 dhjetor dhe i ftoi deputetët e Komisionit që të jenë në këtë vizitë.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetar i Komisionit,

Muhamet Mustafa